

FTESË PËR OFERTË

Numri i prokurimit: T-0011-11-2019

I. Autoriteti kontraktues: Banka për Biznes, Sh.a.

II. Lënda e kontratës: "Sistem për Menaxhimin e Marrëdhënieve me Klientë - CRM"

III. Procedura e përdorur: E hapur

IV. Kushtet e ofertimit:

a) Afati kohor dhe vendi i dorëzimit të ofertave:

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertës në bankë është **20 nëntor 2019** deri në ora **14:00**.
- Adresa: Zyra e Prokurimit në Qendër, rr. Ukshin Hoti, nr. 128, Prishtinë, Kosovë.

b) Oferta financiare dhe Oferta teknike duhet të ndahen nga njëra tjetra nëpër pliko (zarfa) të veçantë dhe të dyja së bashku me rastin e dorëzimit të ofertës duhet të vendosen në një zarf të përbashkët, në të cilin duhet të shënohet vetëm numri referues dhe përshkrimi i tenderit për të cilin e dorëzoni ofertën tuaj.

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm ligjor – certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe certifikatën e numrit fiskal.
- Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit, duhet të përfshijnë të gjitha taksat e aplikueshme.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqes referenca/dëshmi nga institucionet me reputacion të lartë mbi shërbimet e ngjashme të ofruara gjatë 3 viteve të fundit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Oferta duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anuloj tenderin dhe/ose të ndryshoj karakteristikat e tenderit dhe t'i ftoj sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **07 nëntor 2019** në email adresën prokurimi@bpbbank.com dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-14:00.